

Npi – 01/76 datë: 01.04.2020

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) dhe nenit 44 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenin 29 dhe 30.5 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048; Nenin 91 të Ligjit për Fatkeqësit Natyrore Nr.04/L-027; Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/11 të datës 15.03.2020; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Shtimes, për formimin e Shtabit Komunal Emërgjent Nr.02/78 të datës 13.03.2020, si dhe në bazë të nenit 50.2 të Statutit të Komunës së Shtimes Nr.01-06/1636 dt. 03.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e Jashtëzakonshme të mbajtur më: 01.04.2020, Aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E 100,000.00 EURO PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË PANDEMISË KOVID-19

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e Jashtëzakonshme për vitin 2020 të mbajtur më: 01.04.2020, unanimitisht aprovoi Vendimin për ndarjen e mjeteve financiare Buxhetore në shumën prej 100,000.00€ (njëqind mijë euro) për parandalimin e përhapjes të sëmundjes (Pandemisë) e quajtur Korona-Virusi (KOVID-19).

II

Mjetet financiare të ndara sipas dispozitivit të këtij vendimi në shumën prej 100,000.00€ do të merren nga programet Buxhetore si vijon:

1. Programi 16307 - Administratë dhe Personel, shuma prej 50,000.00€,
2. Programi 73450 - Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale, shuma prej 20,000.00€,
3. Programi 93180 - Arsimit dhe Shkencë, shuma prej 30,000.00€

Kjo shumë e mjeteve financiare do të kthehet Buxhetit të vitit fiskal 2020, përmes bartjes së të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga viti paraprak 2019.

III


Kërkesat emërgjente nga Shtabi Komunal Emërgjent, dorëzohen te autorizuesi i Buxhetit për ekzekutimin e tyre. Ekzekutivi i Komunës do të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi.

IV

A r s y e t i m: Duke u bazuar në mundësitë Buxhetore të Komunës së Shtimes, Kuvendi i Komunës aprovoi vendimin për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 100,000.00€. Kjo shumë është ndarë me qëllim që të mbulojë kërkesat emërgjente të Shtabit Komunal të Emërgjencës, si dhe Nënshtabet Komunale, e që kanë për qëllim primar parandalimin e përhapjes të Infektimit të qytetarëve me virusin korona, si dhe menaxhimin më të mirë të gjendjes së krijuar nga ndikimi i Pandemisë e quajtur Korona-Virus ose (KOVID-19). Kërkesat emërgjente të Shtabit mund të jenë, furnizim me pajisje mbrojtëse, medikamente, pako ushqimore, pako higjienike, si dhe projekte të tjera për dezinfektim.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Zyrës për Financa, Kryetarit të Komunës, Zyrës për Informim, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, dhe Ministrisë për Financa.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj